# DËSHMI ARKIVI

**A-441665**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | U përfshi në një aksident automobilistik pasi shënoi golin e fitores, djali i Paolo Maldinit rezultoi pozitiv në testin e alkoolit |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/13/u-perfshi-ne-nje-aksident-automobilistik-pasi-shenoi-golin-e-fitores-djali-i-paolo-maldinit-rezultoi-pozitiv-ne-testin-e-alkoolit/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 20:24:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 shtator 2026, 20:17:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 shtator 2026, 20:16:00 UTC → 13 shtator 2026, 20:18:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0616642b267b110522354ddc1fc9c60d8668be07730d5471531b54cec0f8a0a1` |
| TEKSTI | `fdf8861563c16762ef4c59accf09d8175b97d7f6961e414afac41fa44400a558` |
| PAMJA | `af72e9ca41e2c615a038e93a43c8fa3a6344ab8a48b91f10492d1f090f3f3c98` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6b352f27b8dacdb0d9338179e529c55efd99184a0c0af07d45daa85ea6e0bfb4` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `5a17c12c14e78c5a4225635ca4dd5bf0de00406a8b7800bc862a616c14968175` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6b352f27b8dacdb0d9338179e529c55efd99184a0c0af07d45daa85ea6e0bfb4`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# U përfshi në një aksident automobilistik pasi shënoi golin e fitores, djali i Paolo Maldinit rezultoi pozitiv në testin e alkoolit

13/09/2026 22:17




**Futbollisti i Cagliarit, Daniel Maldini, ka rezultuar pozitiv në testin e alkoolit pas aksidentit automobilistik të ndodhur këtë mëngjes në Milano, ku ai ishte në drejtimin e një Porsche Carrera.**

Sipas të dhënave të policisë lokale, Maldini iu nënshtrua dy testeve në vendngjarje. I pari regjistroi 0.91 mg/l, ndërsa i dyti 0.89 mg/l. Për këtë arsye, autoritetet i kanë revokuar lejen e drejtimit.

Vlera e regjistruar në testin e parë korrespondon me rreth 1.82 g/l alkool në gjak, nivel që sipas Kodit Rrugor italian, mbi 1.5 g/l, përfshihet në kategorinë më të rëndë të drejtimit të mjetit nën efektin e alkoolit dhe mund të sjellë pasoja të rënda ligjore.

Ndërkohë, policia dhe autoritetet shëndetësore janë në pritje të rezultateve të testeve për të përcaktuar nëse ka pasur edhe prani të lëndëve narkotike.

Sipas rindërtimit paraprak të policisë, Maldini po drejtonte një Porsche Carrera 4 dhe dyshohet se hyri në Via Caracciolo nga Via Tolentino pa i dhënë përparësi një automjeti Volkswagen Golf.

Porsche e futbollistit goditi pjesën e përparme të Golfit, i cili më pas u përplas me një Mercedes të parkuar në Via Caracciolo.

Në vendngjarje ndërhynë tre ambulanca dhe një ekip mjekësor. Maldini u dërgua në spitalin Fatebenefratelli për kontrolle, ndërsa personat e tjerë të përfshirë në aksident u transportuan në disa spitale të Milanos.

Pas kontrolleve mjekësore, futbollisti u largua nga spitali dhe u kthye në shtëpi.

"Daniel është mirë dhe nuk ka pësuar asnjë lëndim, e lëre më serioz", deklaroi avokati i tij, Danilo Buongiorno, duke shtuar se Maldini u lirua menjëherë pas një kontrolli të shkurtër në urgjencë.

**Top Channel**

## SPORT • KRYESORE



Renditja/ Elbasani i bën "nder" Teutës, durrsakët kryesojnë të vetëm, Vllaznia në krizë të thellë. Si paraqitet situata në Superiore pas javës së katërt



Kaos në Kurbin, Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz stadiumin, Laçi përfiton dhe merr 3 pikët



Formula 1/ Antonelli është i pandalshëm, italiani triumfon në Madrid dhe sheh titullin kampion t'i afrohet akoma më shumë



Barcelona dhuron sërish spektakël, mund Levanten dhe ruan me pikë të plota kreun e La Ligës



Ekskluzive/ "S'kam gjë nga zemra, por…", rrëfimi shokues i Lorenc Trashit pas tmerrit në fushë

## Serie A »







## ME TË LEXUARAT

Serbia e kishte kapiten, Kosova e mori, Lille i hapi derën, si u shua karriera e Arton Zekajt

"Ky nuk është më futboll", Ronaldo shpërthen ndaj tifozëve të Al-

Napoli, Allegri pas fitores: Shpresojmë të jetë një fillim i mirë

13/09 21:47

Daniel Maldini, pozitiv në testin e alkoolit, i hiqet patenta pas aksidentit

13/09 21:24

Napoli rigjen buzëqeshjen pas 3 humbjeve radhazi, mposht Bolognan

13/09 20:22



'Kurrë mos u dorëzo'/ Maignan jep mesazhe në rrjetet sociale, por shfaqet edhe një bisedë

13/09 17:48



Albumi i kujtimeve i Marco Branca: Për Cecchi Gori isha i bukur si aktor. Kur mora Sneijder u zura me Mourinhon sepse...

13/09 11:42



Frikë për djalin e Paolo Maldinit, përfshihet në një aksident me makinë pak orë pasi shënoi golin e fitores në Serie A

13/09 11:04

## Sport »



Napoli, Allegri pas fitores: Shpresojmë të jetë një fillim i mirë

13/09 21:47



Daniel Maldini, pozitiv në testin e alkoolit, i hiqet patenta pas aksidentit

13/09 21:24



Bayern-i rikthehet te fitorja, kampionët e Gjermanisë mundin me vuajtje surprizën e bukur të këtij sezoni

13/09 21:19



Renditja/ Elbasani i bën "nder" Teutës, durrsakët kryesojnë të vetëm, Vllaznia në krizë të thellë. Si paraqitet situata në Superiore pas javës së katërt

13/09 20:39



Egnatia nuk është e pamposhtur, Elbasani i shkakton humbjen e parë rrogozhinasve në kampionat

13/09 20:29



Napoli rigjen buzëqeshjen pas 3 humbjeve radhazi, mposht Bolognan

13/09 20:22

## Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top News- Viti i Ri Hebre, kryerabinj Yoel Kaplan: Shqipëria të vazhdojë të jetë mikpritëse



Top Channel/ Mitsotakis sfidon Erdoganin: Zotërojmë të drejtën e zgjerimit me 12 milje



Top Channel/Pagat,Rama gozhdon gjyqtarin:E pabesueshme si e sheh buxhetin e shtetit si "qesen e vet"



Top News- Zjarr pranë stallave të lopëve në Valare, zjarrfikësit




Lajmet kryesore të ditës – Top News, 13 Shtator 2026



Top News- Rama flet pas përplasjes në Polican: Nuk cenon shërbimet

Taawoun: Të ndalohen përgjithmonë nga stadiumet

Frikë për djalin e Paolo Maldinit, përfshihet në një aksident me makinë pak orë pasi shënoi golin e fitores në Serie A

Kaos në Kurbin, Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz stadiumin, Laçi përfiton dhe merr 3 pikët

Ekskluzive/ "S'kam gjë nga zemra, por...", rrëfimi shokues i Lorenc Trashit pas tmerrit në fushë

"Hiqi të gjitha, më pëlqen ngjyra blu"/ Kapet mat ish-futbollisti i Premier League-s, paguante modelen që të sillej si ish e dashura e tij

Formula 1/ Antonelli është i pandalshëm, italiani triumfon në Madrid dhe sheh titullin kampion t'i afrohet akoma më shumë

Nuk luajnë më, por fitojnë miliona, lista e sportistëve më të pasur pas pensionimit

Renditja/ Elbasani i bën "nder" Teutës, durrsakët kryesojnë të vetëm, Vllaznia në krizë të thellë. Si paraqitet situata në Superiore pas javës së katërt

Skandal në Arabi, tifozët këndojnë kundër Diogo Jotas për të provokuar Neves: Pas asaj që bënë...




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.